# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-477975**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Media italiane rekomandon Tiranën mes alternativave për pushime në vjeshtë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/turizem/media-italiane-rekomandon-tiranen-mes-alternativave-per-pushime-ne-vjesh-i589066` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 06:32:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 06:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d59932e00eb87280004e5c2f9edf1bfa468ecd5ce6c705c0c14dcefd4d0948c4` |
| TEKSTI | `c153b4a7bf8f303b9278b34323c77609a09739628399a9c90f784e71a3e942f9` |
| PAMJA | `4efe206afb45cdc4e4219050165c94d11a11f59ae252cbcbcd0dee99a6814491` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1d63f1cf6425cd95ac97987a2fac6867edb278d746f728597b99f6b070ff3bbc` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5eafe312c168c8cb7947308588661084dd025e8060ada60f7d94b18122ee4218` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1d63f1cf6425cd95ac97987a2fac6867edb278d746f728597b99f6b070ff3bbc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Media italiane rekomandon Tiranën mes alternativave për pushime në vjeshtë

TemA

29 Shtator 2026, 08:25Turizëm TEMA



Tirana po konsolidohet si një nga destinacionet urbane në rritje në Evropën Jugore, duke kombinuar jetën e gjallë të kryeqytetit, ofertën kulturore dhe kulinare me afërsinë me destinacionet bregdetare të Shqipërisë.

Media italiane "Il Resto del Carlino" e ka renditur kryeqytetin shqiptar mes katër destinacioneve, të sugjeruara për udhëtime në vjeshtë dhe me kosto të përballueshme.

Aeroporti i Bolonjës ofron një gamë të gjerë destinacionesh, që mund të arrihen me fluturime direkte dhe me tarifa të përballueshme, duke krijuar mundësi për pushime të shkurtra ose për një udhëtim më të gjatë gjatë sezonit të vjeshtës.

Pas muajve të verës, kur shumica e udhëtimeve përqendrohen në korrik dhe gusht, një numër gjithnjë e më i madh turistësh, zgjedhin vjeshtën për të pushuar, për të zbuluar destinacione të reja dhe për të shijuar ditët e fundit të verës.

Mes alternativave të preferuara janë kryeqytetet evropiane dhe destinacionet bregdetare, të cilat në vjeshtë, mund të ofrojnë temperatura më të ngrohta dhe më pak fluks turistësh krahasuar me muajt e sezonit të lartë.

Shtatori konsiderohet një periudhë e përshtatshme për udhëtime, edhe për shkak të tarifave përgjithësisht më të ulëta të fluturimeve, ndërsa vizitat në qytetet turistike mund të zhvillohen në një atmosferë më të qetë, larg fluksit të madh të turistëve gjatë korrikut dhe gushtit.

Ndër destinacionet që mund të arrihen me fluturime direkte nga Bolonja janë, Budapesti në Hungari, Palma de Majorka në Spanjë, Tirana në Shqipëri dhe Zara në Kroaci.

**Tirana, Shqipëri: Një destinacion gjithnjë e më tërheqës**

Tirana paraqitet si një prej destinacioneve në zhvillim në Evropën Jugore, e njohur për jetën urbane, ofertën turistike dhe gastronomike në rritje.

Kryeqyteti shqiptar vijon të tërheqë një numër në rritje vizitorësh dhe përbën një alternativë të përshtatshme edhe gjatë muajve të vjeshtës, kur temperaturat janë më të moderuara dhe fluksi turistik është më i ulët krahasuar me kulmin e sezonit veror.

Sipas artikullit, lidhjet ajrore nga Bolonja drejt Tiranës ofrojnë tarifa të favorshme.

Për shembull, gjatë kësaj periudhe, biletat vajtje-ardhje janë ofruar për më pak se 50 euro.

Artikulli përfshin gjithashtu si destinacione për udhëtime në vjeshtë; Budapestin në Hungari, Palma de Mallorcën në Spanjë dhe Zaran në Kroaci.

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shqipëria pret 9.4 milionë të huaj në 8 muaj, INSTAT publikon shifrat e reja]

19:30 Turizëm

[Shqipëria destinacion për vjeshtën - “Time Out”: Riviera shqiptare, e mrekullueshme]

15:20 Turizëm

[Gushti sjell rekord lëvizjesh: 2.4 milionë të huaj vizituan vendin vetëm gjatë këtij muaji]

14:40 Turizëm

Gjermanët “eksplorojnë” Gjirokastrën, motoçiklistët vlerësojnë natyrën si dhe kulinarinë tradicionale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.